



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveri-Vlada-Government

**RREGULLORE (QRK) Nr. 05/2026 PËR NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E RREGULLORES (QRK) Nr. 09/2019 PËR INTEGRIMIN E
TË HUAJVE¹**

¹ Rregullorja (QRK) Nr. 05/2026 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve, është miratuar në Mbledhjen e 11-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 12/11 të datës 20.04.2026.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe nenin 108, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 06/L-026 për Azil, si dhe nenin 126 dhe nenin 137, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, nenin 8, paragrafi 4, nënparagrafi 4.5, të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 78, paragrafi 6, nënparagrafi 6.2, të Rregullores (QRK) Nr. 17/2024 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) Nr. 05/2026 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES (QRK) Nr. 09/2019 PËR INTEGRIMIN E TË HUAJVE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve.

Neni 2 Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj rregulloreje është i njëjtë me fushëveprimin e rregullores bazë.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. Rregullorja bazë – Rregullorja (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve.

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Rregulloren bazë, Ligjin për Azil, si dhe Ligjin për të Huajt.

3. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në njërin gjini nënkuptojnë edhe gjininë tjetër.

Neni 4

Neni 7 i Rregullores bazë riformulohet si në vijim:

1. DSHAM, respektivisht Divizioni për Azil, njofton DRPRIH-në dhe përcjell vendimet për njohjen e statuseve të mbrojtjes ndërkombëtare, si dhe informatat bazë, në përputhje me këtë rregullore.

2. MPB/DSHAM përkujdeset që, në afatin sa më të shkurtër të mundshëm kohor, t'i pajisë të huajt me dokumente për leje qëndrimi dhe dokumente udhëtimi, si parakusht për qasjen e tyre në procesin e integritimit

Neni 5

Pas nënparagrafit 2.1 të paragrafit 2 të nenit 19 të Rregullores bazë, shtohet nënparagrafi i ri 2.1A, si në vijim:

2.1A. Pako ushqimore, higjienike dhe materiale.

Neni 6

Pas nenit 20 të Rregullores bazike shtohet një nen i ri 20A, si në vijim:

Neni 20A

Pako ushqimore, higjienike dhe materiale

3. Pako ushqimore, higjienike dhe materiale sigurohen për personat përfitues nga skemat e integritimit, të cilët janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale, dhe të cilët, për shkak të moshës, gjendjes shëndetësore ose sociale, nuk janë në gjendje të sigurojnë mjete të nevojshme për jetesë.

4. DRPRIH, bazuar në vlerësimin e nevojave të përcaktuara me këtë rregullore, siguron pako ushqimore, higjienike dhe materiale. Pas vlerësimit të nevojave, në raste të veçanta, DRPRIH bashkëpunon me ministritë përgjegjëse dhe organizatat përkatëse për ofrimin e kësaj skeme.

Neni 7

Pas paragrafit 1 të nenit 23 të Rregullores bazë shtohet paragrafi i ri 1A, si në vijim:

1A. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, personat me mbrojtje ndërkombëtare mund të përfitojnë akomodim me qira edhe pas kalimit të periudhës prej dy (2) viteve, në rast se nuk kanë mundësi të tjera banimi ose, për shkak të gjendjes së rëndë socio-ekonomike, nuk janë në gjendje të përballojnë shpenzimet e akomodimit. Në këto raste, akomodimi mund të vazhdojë edhe pas kësaj periudhe, nëse një gjë e tillë vlerësohet si e domosdoshme nga DRPRIH, QPS dhe ZKKK.

Neni 8

Paragrafi 4 dhe 5 i nenit 34 të Rregullores bazë fshihen.

Paragrafi 1 i nenit 34 të Rregullores bazë ndryshohet si më poshtë:

Paragrafi 1. Buxheti për zbatimin e masave të integritit të të huajve sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme çdo vit, si pjesë integrale e buxhetit shtetëror, duke garantuar mbështetje efektive për realizimin e këtyre masave.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

22.04.2026